



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**AUTORITETI I KONKURRENCËS**  
**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**V E N D I M**

**Nr. 488, Datë 05.12.2017**

**“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit”**

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 8 dhe 9, nenit 24, shkronja d, dhe nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar),

**V E N D O S I:**

1. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit.
2. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 01/06/2016 deri në 30/11/2017;
3. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 2 (dy) muaj nga marrja e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**